



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 33, Datë 27.03.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“PROTERGIA ENERGY ALBANIA” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.03.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 690/1 prot., datë 28.02.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 690 prot., datë 22.02.2024, ka paraqitur aplikimin për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke kërkuar dhe vijimësinë e procedurës së licencimit me procedurë të përshpejtuar, pasi shoqëria “Protergia Energy Albania” sh.p.k. (kompani bijë e Protergia Energy SA, me seli në Athinë të Greqisë), kërkon të regjistrohet pranë Bursës Shqiptare të Energjisë, të themeluar në Shqipëri.
- Për sa i përket kërkesës për procedurë të përshpejtuar, ajo nuk plotëson kriteret e nenit 37, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, 17.06.2016, pasi aplikuesi nuk ka dhënë një shkak të arsyeshëm për këtë kërkesë, ndaj vlerësohet të vijohet me procedurën e zakonshme të licencimit, sipas kërkesave dhe afateve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të Rregullores, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.4 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “PROTERGIA ENERGY ALBANIA” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NE DETYRE

Erjola SADUSHI